VENDIM
Nr. 31, datë 24.6.2016

PËR LICENCIMIN E UJËSJELLËS
VAU I DEJËS SHPK

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit, operatorit Ujësjellës Vau i Dejës sh.p.k., me:
   Drejtues ligjor : Kol Ndokaj
   Drejtues teknik: Ramazan Geci
2. Operatori Ujësjellës Vau i Dejës sh.p.k. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
   Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik;
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Vau i Dejës.
4. Kjo licencë është e vlefshme deri në datën 31.12.2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani